

510 TITULLI I SAKTË PARALEL

Fusha përmban titullin paralel që është titulli i saktë në gjuhën ose shkrimin tjetër.

Nënfushat & përsëritshmëria

FUSHA/NËNFUSHA		PËRSËRITSHMËRIA
510	Titulli i saktë paralel	r
a	<i>Titulli paralel</i>	nr
e	<i>Informacioni tjetër për titullin</i>	r
h	<i>Numri i pjesës</i>	r
i	<i>Titulli i pjesës</i>	r
z	<i>Gjuha e titullit paralel</i>	nr

Treguesit

TREGUESI	VLERA	KUPTIMI
1		<i>Rëndësia e titullit</i>
	0	<i>Titulli nuk është i rëndësishëm</i>
	1	<i>Titulli është i rëndësishëm</i>
2		<i>Nuk është i përcaktuar</i>

Vlera e treguesit të parë përcakton përshkrimet shtesë në sistemet, të cilat shtypin skedat për katalogun manual. Nëse treguesi ka vlerën "1" bëhet përshkrimi shtesë për titullin e saktë paralel.

PËRSHKRIMI I NËNFUSHAVE

510a Titulli paralel

Titulli kryesor i njësisë në gjuhën ose shkrimin tjetër, i lidhur me titullin e saktë në nënfushën 200a.

510e Informacioni tjetër për titullin

Nintitujt dhe informacionet e tjera për titullin që shfaqen pranë titullit paralel në nënfushën a.

510h Numri i pjesës

Numri i pjesës që lidhet me titullin paralel në nënfushën a.

510i Titulli i pjesës

Titulli i pjesës që lidhet me titullin paralel në nënfushën a.

510z Gjuha e titullit paralel

Kodi për gjuhën e titullit paralel.

SHËNIME PËR PËRMBAJTJEN E FUSHËS

Fusha përdoret për titullin paralel, për të mundësuar kërkimin e tij dhe kur dëshironi të bëni përshkrim shtesë për të.

FUSHAT NË LIDHSHMËRI

200d *TITULLI DHE TË DHËNAT PËR PËRGJEGJËSINË, Titulli i saktë paralel*

Kur titulli paralel shfaqet bashkë me titullin e saktë, informacionet e tjera për titullin dhe të dhënat për përgjegjësinë në formën dhe renditjen nga njësia, ai vendoset në fushën 200. Nëse për titullin paralel dëshironi të bëni përshkrim shtesë atë e shënoni edhe një herë në fushën 510.

304 *SHËNIMI PËR TITULLIN DHE PËRGJEGJËSINË***

Fusha mund të përmbaj shënimin për titullin paralel ose vetë titullin paralel, nëse ai nuk është shënuar në fushën 200.

541 *TITULLI I PËRKTHYER I VËNË NGA KATALOGUESI*

Tituj paralel janë titujt në gjuhët e tjera, të cilët ndodhen në njësi. Nëse titulli nuk është në njësi dhe atë e përkthen kataloguesi ose atë e merr nga një burim tjetër, ai shënohet në fushën 541.

SHEMBUJ

1.

200	1□	a Resúmenes sobre población en América Latina f Programma de información sobre Población en America Latina d Latin American population abstracts f Latin American Population Information Program zeng
510	1□	a Latin American population abstracts zeng (Titulli kryesor dhe ai paralel janë vendosur në fushën 200 për shkak të përshkrimit. Institucioni katalogues ka nevojë për përshkrim shtesë të titullit, për këtë arsye titulli në gjuhën angleze është vendosur edhe në fushën 510.)

2.

200	1□	a Information transfer
510	1□	a Transfert de l'information zfre

(Në fushën 510 është vendosur titulli paralel për shkak të përshkrimit shtesë dhe për shkak të kërkimit.)

3. *

200	1□	a Post- und Eisenbahn-Reisekarte Deutschland, Holland, Belgien, die Schweiz, Italien bis Neapel, der größte Theile von Frankreich, Ungarn, Polen etc. b Kartografsko gradivo e mit besondere Rücksicht auf Eisenbahnen u. Seedampfschiffahrt f Originalzeichnung v. G. Hanser g Stahlstich der Kunst- u. geograph. Anstalt in Nürnberg
300	□□	a Na ov. nasl. v franc.: Carte de voyage par voies de poste et chemins de fer en Allemagne, Hollande, Belgique, dans presque toute la France, en Suisse, plus de l'Italie à Naples, de l'Hongrie, de la Pologne, etc.
510	0□	a Carte de voyage par voies de poste et chemins de fer en Allemagne, Hollande, Belgique, dans presque toute la France, en Suisse, plus de l'Italie à Naples, de l'Hongrie, de la Pologne, etc. z fre

4. * COBISS.net

200	1□	a Krijimi i mjedisit për sjelljen e inovacionit d Shaping the environment for innovation transfer
510	1□	a Shaping the environment for innovation transfer z eng